ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit - Nr. i AP: **616-23-6444-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ofrimi i shërbimeve për mobilitet (Lot 1 dhe Lot 2)**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

____Grupi i OE "ABNID SHPK; CADCOM – A SH.P.K.; ADVANTECH SHPK"____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____ Rruga Rilindja - Lagjja Qender Polican, _____
(Adresa)

_____Poliçan_____ **_____1010_____**
(Vendi) *(Kodi postar)*

_____+383 45 361 240_____ **_____**
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

_____ Ganimete Ahmeti _____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ ganimeteagashi@gmail.com _____
(Adresa elektronike)

_____13.11.2023_____ **_____**
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Ofrimi i shërbimeve për mobilitet (Lot 1 dhe Lot 2).**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 28.06.2023 ndërsa hapja publike është bërë në datën 21.08.2023.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë në datën 26.10.2023.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë po i drejtohemi AK-së me këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 03.11.2023 na e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë veprim dhe brenda afatit të rregullt kohorë po i drejtohemi OSHP-së me ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët të Poentuar**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet0:*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Hapja publike është bërë në datën 21.08.2023. Në procesverbalin e hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet;*
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë në datën 26.10.2023. Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë po i drejtohemi AK-së me këtë Kërkesë për Rishqyrtim. AK me datë 03.11.2023 na e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë veprim dhe brenda afatit të rregullt kohorë po i drejtohemi OSHP-së me ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues
Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; **AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së -** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

AK ka shkelur nenin 26.6 të RRPP-001/2022-së - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1. AK përkatësisht Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka shkelur nenin 7 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit të ofertave sepse e ka favorizuar hapur Grupin e OE që e ka shpallur fitues edhe përkundër shumë mangësive që kishte në tenderin e tijë, ndërsa na ka diskriminuar neve duke na i kontestuar çmimet pa asnjë bazë të dëshmuar ligjore. Përpos kësaj, AK gjatë vlerësimit dhe sqarimit të tenderëve e ka favorizuar Grupin e OE edhe kur i ka kërkuar sqarime dhe kur i ka pranuar dokumente dhe dëshmi që tregojnë hapur se janë krijuar pas afatit të fundit për tenderim. Kjo përpos që konsiderohet favorizim dhe veprim i kundërligjshëm sipas nenit 7 të LPP-së, veprimi i tillë konsiderohet edhe shkelje e plotë e nenit 72 të LPP-së. Pra veprimi i AK-së me rastin e eliminimit tonë konsiderohet si diskriminim ndërsa shpallja fitues e Grupit të OE INTRAST SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K. është favorizim i hapur sepse kjo e fundit është plotësisht e papërgjegjshme. Krejt kjo tregon se AK nuk i ka trajtuar OE si të barabartë dhe se ky veprim konsiston me shkelje të plotë të nenit 7 të LPP-së. Mungesat e këtij Grupi të OE do të i cekim detalisht tek pretendimi i radhës.

Pretendimi 2 . AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

E themi këtë dhe e citojmë ligjin sepse ne jemi eliminuar nga konkurrenca me arsyetime të pabazuara kinse për çmime të larta edhe pse tenderi jonë është brenda vlerës së parashikuar të AK-së. Ja si duet arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë:

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Grup i Operatorëve Ekonomik ADNID SHPK; CADCOM - A SH.P.K.; ADVANTECH SHPK kanë ofruar çmime të papërballueshme për AK.
Nëse aprovohen këto cmime është në dëm te Autoriteti Kontaktues .
Ofrimi i cmimeve është i papranueshëm për pozicione

Këtë arsyetim nuk mundet t'a mbështes AK me asnjë bazë ligjore të LPP-së e as të Rregullores andaj me plot të drejtë e kontestojmë si arsyetim të paligjshëm dhe të pabazuar.

AK nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së as me rastin e vlerësimit të tenderit të Grupit të OE që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti ka mangësi të theksuara në tenderin e tijë. Mangësitë e tilla e bëjnë plotësisht të papërgjegjshëm Grupin e OE të shpallur fitues ku në vazhdim do të i cekim secilën veç e veç.

AK kishte kërkuar në FDT që OE të kenë projekte të realizuar anë tre vitet e fundit dhe atë vlerën 300,000.00€ vetëm për një Lot. Ja si dukej kërkesa e tillë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre studime dhe analiza te trafikut dhe transportit si dhe projektime me vlerë minimale prej 300,000 Euro në 3 (tri) vitet e fundit PER LLOT**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur**

Këtë kriter nuk ka arritur t'a plotësoj Grupi i OE të shpallur fitues sepse vlera e projekteve të paraqitura nuk e arrijnë shumën që të mbuloj të dy Lot-et për të cilat ka aplikuar. Tre projektet në listën e dytë janë të jashtë afatshme ndërsa tek lista e parë nuk janë të gjitha të natyrës së projektit për të cilin ka aplikuar. Përpos kësaj projektet e paraqitura nuk janë të mbuluar me dëshmi të nevojshme që tregoj se janë realizuar me sukses. Edhe pse për dëshmi AK kishte ngatërruar kërkesën ku në vend të listës së kontratave dhe referencave kishte kërkuar "**Deklaratat tatimore të ATK dhe raporte financiare të audituara nga një auditor i certifikuar**". Asnjëra nga këto nuk janë dorëzuar sepse ky grup i OE ka dorëzuar disa raporte të ATK-së të nxerrura nga sistemi por jo deklaratat tatimore siç janë kërkuar nga AK. Mungesa e dëshmive të tilla të kërkuara nga AK për projekte të realizuara, e bënë këtë Grup të OE të papërgjegjshëm.

AK kishte kërkuar edhe autorizimin e prodhuesit për Radar dhe Bluetooth dhe kërkesa ishte paraqitur kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Operatori ekonomik duhet te dorezoj Autorizimin origjinal te prodhuesi apo dillerit te autorizuar për Pajisje RADAR dhe Bluetooth për mbledhjen e të dhënave.**	**Autorizimin origjinal te prodhuesi apo dillerit te autorizuar për Pajisje RADAR dhe Bluetooth për mbledhjen e të dhënave.**

Grupi i OE i shpallur fitues nuk kishte arritur të e plotësoj këtë kërkesë sepse autorizimi i tillë nuk është për të dy llojet e pajisjeve të kërkuara. Grupi i OE në fjalë kishte dorëzuar dëshmi se kompania e tillë autorizuese prodhon pajisjet RADAR por jo edhe pajisjet **Bluetooth** për mbledhjen e të dhënave. Edhe pas kërkesës për sqarim nga AK dhe dorëzimit të sqarime nga Grupi i OE në fjalë, kjo gjë nuk kishte arritur të sqarohet dhe plotësohet dhe se kompania autorizuese nuk prodhon pajisje Bluetooth çka e bënë autorizimin e tillë të papranueshëm. Mungesa e autorizimit të rregullt këtë Grup të OE e bënë të papërgjegjshëm(*shiko dëshmitë*

dorëzua në tender dhe sqarim ku askund nuk mundet të gjenden të dhënat për pajisjen Bluetooth).

AK kishte kërkuar që OE të kenë software bashkëkohore për analizë dhe studim të rrjetit e cila duhej dëshmohej me faturë të blerës. Ja si duket kërkesa e tillë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**OE duhet te ketë ne dispozicion software bashkohore për analizë, studim te rrjetit te trafikut, optimalizim dhe simulime te gjendjeve.**	**Faturat e blerjes dhe kontraten**

Grupi i OE nuk e kishte paraqitur fillimisht dëshminë e posedimit të softwareve të tilla andaj AK i ka kërkuar sqarim shtesë. Sqarimi i tillë nuk mundet të kërkohet për dëshmitë tilla siç janë faturat e blerjes sepse si të tilla ato munden edhe të modifikohen pra nuk janë dëshmi objektivisht të verifikueshme. Mungesa e dëshmive për posedim të softwareve të tilla e bënë Grupin e OE të shpallur fitues të papërgjegjshëm. Edhe sqarimi i ofruar sipas nenit 72 të LPP nuk mundet të lejohet sepse përbënë plotësim substancial të ofertës e që tenderin në fjalë e bënë të papërgjegjshëm.

Kërkesa për katalogje dukej kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Operatori ekonomik duhet te dorezoj Katalogët e detajuara për secilin produkt**	**Katalogët e detajuara për secilin produkt Specifikimeve teknike te detyrueshme**

Grupi i OE nuk ka arritur të dorëzoj dëshmi të mjaftueshme sepse nuk ka paraqitur asnjë të dhënë tek katalogjet e ofruara për pajisjet Bluetooth që shërbejnë për mbledhjen e të dhënave. Mungesa e katalogut të tillë e bënë tenderuesin në fjalë të papërgjegjshëm.

AK në kuadër të kërkesave mbi mundësit teknike dhe profesionale kishte kërkuar që OE të jenë të pajisur me certifikata ISO. Kërkesa ishte parashtruar në këtë mënyrë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Operatori ekonomike duhet te dorezoj Certifikata ISO EN 9001dhe 14001**	**Certifikata ISO EN 9001dhe 14001**

Grupi i OE kishte paraqitur certifikatat e tilla por ato ishin paraqitur vetëm për njërin nga anëtarët e konzorciumit dhe duke u bazuar në nenin 26.6 të RRPP-001/2022, plotësimi i këtij kushti ka dështuar çka e bënë grupin e tillë të papërgjegjshëm. Ja si e përshkruan kërkesën e tillë nenin 26.6 i RRPP-001/2022:

> 26.6 Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dështoj se i përmbush standardet përkatëse.

Pra bazuar në këtë kërkesë të rregullores e cila ka hy në fuqi në muajin e 11 të vitit 2022, certifikatën ISO EN 9001 dhe 14001 duhet ta kenë të gjithë anëtarët e konzorciumit. Kjo nuk

është dorëzuar për anëtarin e dytë ku pas hulumtimit shihet se ai nuk është fare as i certifikuar për këto standarde dhe mungesa e tillë e bënë Grupin e OE plotësisht të papërgjegjshëm.

AK kishte kërkuar edhe që OE të jenë të pajisur me staf profesional si në vazhdim.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Ekspert kyç 1 Udhëheqësi i projektit Kualifikimet dhe aftësitë Planer Planifikues urban (hapësinor) (Master, Fakulteti I Arketktures apo apo drejtimi planifikim hapsinor) Përvoja e përgjithshme profesionale minimum 7 vite përvojë pune në planifikim urban hapësinor.** **Ekspert kyç 2 Kualifikimet dhe aftësitë Planer i transportit (master) Përvoja e përgjithshme profesionale 7 vite përvojë pune** **Ekspert kyç 3 Kualifikimet dhe aftësitë Inxhinier (Master) i komunikacionit rrugor (Fakulteti I makinerisë drejtimi komunikacion rrugor) Përvoja e përgjithshme profesionale 7 vite përvojë pune në projektim të fushës së komunikacionit rrugor.** **Ekspert kyç 4 Kualifikimet dhe aftësitë GIS Ekspert (I certifikuar) Përvoja e përgjithshme profesionale 7 vite përvojë pune në hartimin e software-ve** **Ekspert kyç 5 Kualifikimet dhe aftësitë Inxhinier (master) i arkitekturës Përvoja e përgjithshme profesionale 7 vite përvojë pune në projektim 1 Gjeodet i licencuar; 1 Inxhinier i ndërtimtarisë**	**Për te gjithë personelin profesional CV-te, Diploma, Certifikata per ekspertin nr.4, licensa per Gjodetin, Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt dhe referencat per përvojën e punës.**

Grupi i OE nuk ka arritur të i dorëzoj të gjitha dëshmitë e kërkuara për Ekspertin e parë dhe atë të tretin dhe AK më vonë gjatë vlerësimit i ka kërkuar sqarim të tenderit.
Me rastin e sqarimit të tenderit Grupi i OE në fjalë kishte dorëzuar dëshmi që posedojnë datën më të vonshme se sa data e hapjes publike të cilat nuk mund të pranohen si dëshmi të rregullta për qëllimin e dorëzuar. Fjala është për referencën e z. Modest Gashit e cila është lëshuar me datën 16.10.2023 ndërsa hapja publike ka qenë me datë 21.08.2023. Ja si duket dëshmia e tillë:

VIZION
PROJECT

16/10/2023
Kujtdo qe i nevojitet:

REFERENCË

Me anë te këtij dokumenti Vërtetojmë se **z. Modest Gashi** ka qene i angazhuar ne pozitën e **URBANISTIT.**
Z. Gashi ka qene pjesë e këtije projekti:

- Hartimi i **Hartës Zonale** ne Qytetin e Prizrenit.
- Hartimi i **Hartës Zonale** ne Qytetin e Skenderaj.

Z. **MODEST GASHI** i ka përmbushure me sukses të gjitha kushtet e parapara me kontratë afateve të caktuara kohore. Gjatë implementimit te projektit institucioni jonë ka pasure mirëkuptim me Z. **MODEST GASHI.**

Me këtë Referencë ju prezantojmë një PROFESIONISTE shumë serioze, të kompletuar dhe përgatitje të lartë të performancës se planifikimit urban.

N.N.SH. "VIZION PROJECT"

Adresa: Bregu i Diellit, 10000, Prishtine

Tel: +3838 (0) 45 222 888, e-mail: vizionproject@yahoo.com

Z. SHKELQIM OSMANI

N.N.SH. Vizion Project PRISHTINE REPUBLIKA E KOSOVËS

Referenca e tillë konsiderohet plotësim substancial i tenderit dhe sipas nenit 59.4 si dhe sipas nenit 72 të LPP-së është e papranueshme. Kjo e bënë tenderuesin në fjalë të papërgjegjshëm. Këtë referencë e bënë dokument fiktiv edhe fakti që në CV-in e z. Modest Gashit nuk shkruan askund se ky ka punuar për ose tek kompania **Vizion Projekt** e cila ia ka lëshuar këtë referencë. Pra si dokument konsiderohet i falsifikuar pasi që ndodhia apo përshkrimi i asaj që thuhet në të është i pa vërtet gjë të cilën e ka konfirmuar vet Modesti me CV-in e tijë.

AK ka kërkuar që OE ose Grupi i OE i cili do shpallet fitues, paraprakisht duhet të sjelli dëshmitë sipas nenit 65 të LPP-së siç janë Vërtetimi nga ATK, Vërtetimi nga gjykata për OE dhe vërtetimi nga Gjykata për stafin udhëheqës të kompanisë. Kërkesa dukej kështu:

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.

Kjo nuk shihet se është dorëzuar nga këta dy anëtar të grupit dhe se mungesa e tyre e bënë grupin e OE të papërgjegjshëm. Ne dyshojmë se këta OE nuk janë të rregullt në pagesën e tatimeve si dhe kanë edhe probleme me ligjin me vet faktin që AK i ka fshehur dëshmitë e tilla dhe nuk na i ka prezantuar kur kemi kërkuar qasje në dokumente.

Mungesa këtyre dëshmive e bënë Grupin e OE të papërgjegjshëm ndërsa veprimin e AK-së për shpallje të tij si fitues e bënë të paligjshëm. Nisur nga kjo kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues që ta verifikojnë plotsueshmërinë e këtij kushti nga Grupi i OE i shpallur fitues.

Pra po shihet hapur se AK ka shpërblyer me kontratë në tenderues të papërgjegjshëm me shumë mangësi në tenderin e tyre që si veprim e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 59 të LPP-së.

Pretendimi 3. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së sepse nuk i ka respektuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale të aplikuara në përputhje me nenin në fjalë. Kërkesa për stafin profesional, ISO certifikata, katalogje, projekte të realizuara, posedim të pajisjeve/sofwareve etj. ishte e vendosur saktë sipas nenit 69 të LPP-së por AK nuk i ka respektuar ato gjatë vlerësimit të Grupit të OE që e ka shpallur fitues. Pra mos respektimi i kërkesave të tilla e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 69 të LPP-së.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 26.6 të RRPP-001/2022 pasi që edhe pse njëri nga anëtarët e konzorciumit nuk ishte i pajisur me ISO certifikatat e kërkuara nga AK, kjo e fundit prap e shpallë si fitues duke anashkaluar dhe shkelur plotësisht dispozitën në fjalë. Pra mos aplikimi

dhe mos atribuimi i mungesës së ISO certifikatave për anëtarin e dytë të konzorciumit, e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë nenit 26 të RRPP-001/2022.

Pretendimi 6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që gjatë sqarimit të tenderit të Grupit të OE që e ka shpallur fitues ka pranuar dokumente që ligjërisht nuk lejohet të pranohen në këtë fazë. Pranimi i dokumente që nuk janë objektivisht të verifikueshme si dhe pranimi i dokumenteve që posedojnë datën e krijimit më të vonshme se sa data e hapjes publike, konsiderohet shkelje e plotë e nenit 72 të LPP-së. Detalisht këtë pretendim e shihni të sqaruar tek pretendimi për shkeljen e nenit 59 të LPP-së.

Nisur nga krejt kjo që sqaruam më lart mendojmë se i kemi elaboruar mjaftueshëm shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të prokurimit andaj kërkojmë nga OSHP që pas shqyrtimit të pretendimeve tona të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e **Grupit të OE "ABNID SHPK; CADCOM–A; SH.P.K.; ADVANTECH SHPK"** lidhur me tenderin **"Ofrimi i shërbimeve për mobilitet (Lot 1 dhe Lot 2)** i iniciuar nga **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që besojmë se më pas do duhej që **Fitues** të shpallej **Grupi i OE "ABNID SHPK; CADCOM–A; SH.P.K.; ADVANTECH SHPK".**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 Njoftim per Kontrat
- 2 Template per Dosja e Tenderit shqip
- 3 specifikimi teknik
- 4 LLOT I
- 5 LLOT II
- 6 - B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara (2)
- 7 - B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara (3)
- 8 Procesi i hapjes
- 9 B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit - INTRAST
- 10 Sqarimet INTRAST
- 11 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK
- 12 KERKESE PER RISHQYRTIM - ABNID SHPK - 31.10.2023
- 13 Vendim per rishqyrtim - 03.11.2023
- Oferta e INTRAST SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K.
- Sqarimet e INTRAST SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K

Vërejtje: **Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet tona e gjeni të bashkangjitur por i njëjti është edhe në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në AK.** ****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*